

Procesverbal

Nga Mbledhja II (e dytë) e rregullt për vitin 2025 e Komitetit për Politikë dhe Financa , e mbajtur më datë: 27.02.2025

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e dytë të rregullt; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e dytë të rregullt të KPF-së për vitin 2025! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë! Para se ta qesim në votim, a do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës?

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Para se me ia nis seancës, unë i kam nja dy shqetësime, kryesuese. E para është që ka pas shumë material voluminoz edhe nuk e kemi në kopje fizike. S’kemi mund na me e marrë krejt me e shqyrtue materialin. Edhe e dyta është që vetë ju keni premtue që ditëve të premtue seanca nuk do të mbahet, por prapë e njëjta. A është bërë me qëllim, apo nuk e keni kqyrë datën?

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë, Artani i pati dy shqetësime. E para ke që nuk është çue thirrja me kopje fizike. Artan, unë kam kërkue prej zyrës që me ju pru kopje fizike, siç jemi marrë vesh, por ata nuk i kanë printerët në rregull, tonerët nuk janë në rregull. Edhe pse një gjë e tillë është thënë që ka me u bë, por sidoqoftë nuk keni qenë edhe pa këtë, se ne vetë e kemi lyp që kopje fizike mos me pas edhe me i pas lloptopët. Tek e fundit, do ta marrim edhe një vendim – se këta tonera s’kanë – ose me i dorëzue ne lloptopët edhe po shkojmë me kopje fizike. Atëherë, unë një gjë të tillë kam me e qit nesër në Kuvend, edhe do ta bëjmë, përndryshe unë nuk jam fajtor këtu. Sa për te e dyta, unë e di që ju keni lyp që seanca ditën e premtue mos me u mbajt. Unë kam premtue që nuk do ta mbajmë, por unë jam konsultue me disa që të mos e mbajmë në muajin e Ramazanit, por dita e fundit ka qenë e premtja që mu më ka konvnuar. Kështu që, nuk është diçka problem që edhe të premten me u mbajt. Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim? Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zëri kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë.

Atëherë, fillojmë me pikën e dytë: Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e dytë të rregullt. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00773- 1 ZK Dragash. A do dikush me e marë fjalën rreth kësaj pike?

Artan Loshaj: Para se me ia nis pikave të rendit të ditës, që janë shumë voluminoze, unë kisha pas qef sot të jetë prezent drejtori i Financave, ose së paku kryetari të na japë një herë sqarim se çka po ndodh me këto. Arsyeja është interesi publik, por janë do probleme tjera. Që del kryetari, mirë, që nuk del kryetari, unë po vazhdoj, po pata qef me dalë kryetari, me marrë përgjigje prej tij edhe me hy në debat. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Unë dua të jap disa sqarime lidhur me këto shtatë propozimet që i kemi i kemi bërë, për interes të përgjithshëm. Unë po shkoj me rend. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00773- 1 ZK Dragash. Është fjala për objektin pranë Shtëpisë së Kulturës, objekti i Sharr Prodhimit. AKP-ja ka dashtë atë me e qit në shitje, ne kemi kërkuar që mos ta shet, sepse është interesi i Komunës, dhe në një mbledhje të Bordit kemi marrë vendim që t'i propozojmë Kuvendit që ta shapllë se interes të përgjithshëm edhe atë objekt të mos e lëmë me u shit, por të jetë në interes të Komunës. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00807- 0 ZK Dragash – është Parkingu publik përballë xhamisë. Gjithashtu, planifikojmë të bëjmë një parking publik për nevoja të Komunës. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604028-00295- 0 ZK Lubovishtë – është një vend i vogël, diku një ose dy ari, aty ne planifikojmë me e bo një trafo për atë pjesën e Dragashit e cila ka probleme shumë me tensionin e ulët të rrymës. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-01184- 0 ZK Dragash – është ku është kjo Veterinaria, aty ne planifikojmë të bëjmë ndërtimin e banesave sociale. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604006-01063- 0 ZK Brodosanë – është fjala për tokën e cila është pronësi e Komunës, ndërsa ndërtesa është pronësi e Sharr Prodhimit, është ajo pjesa afër Kuklibegut, shkolla e vjetër. Edhe këtu ne kemi propozuar që edhe kjo pjesë të shpallet interes i përgjithshëm dhe do të shfrytëzohet për nevojat e fshatit Bresanë dhe Kuklibeg, për ndërtimin e një parku të gjelbër dhe parkut të lojërave për fëmijë. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik P-70604004-00750- 0 ZK Brezne – është një livadh në pronësi private, ne propozojmë që ta shpallim interes të përgjithshëm, sepse në këtë pjesë ne planifikojmë të ndërtojmë impiantin për përpunimin e ujërave të zeza. Kaq.

Artan Loshaj: Kryesuese, masi janë pesë-gjashtë pika edhe janë të të njëjtit karakter, edhe ti m'i shpjegove, atëherë po filloj edhe unë me rend për secilën. Te parcela 773-1 i ke dy parcela, te Shtëpia e Kulturës. Janë dy parcela aty. Kryetar, unë jam për me i marrë prej AKP-së, edhe me i marrë në pronësi të Komunës. Po këtu unë jam i interesuar – se unë jetoj në Dragash – njëri është park, tejtra

është ndërtesë aty, lokale. Unë sa kam pa, edhe bisedova me drejtorin tënd, disa lokale aty, në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme, nuk e di, por ato parcela janë të marrura, të blera, edhe janë në Kuvendin Komunal janë të qitme personat të cilët i kanë ble ato. Në Komunë figurojnë ato si parcela e Artanit, ose e jotja, ose e dikujt tjetër. A ka mundësi me më shpjegue mu, në qoftë se të lind qe ky problem, qysh do ta zgjidhish. Se ti na thaje neve që AKP ka dashtë me i qit në shitje. Unë s'po di sa me të besue, kur unë me drejtorin – thashë edhe një herë – e ke drejtorin poshtë, shkova me u interesue si asambleist, i thashë për këto që i keni qit, qysh është problemi. Tha tri-katër, edhe me emra i kam aty, kush i ka të bleta edhe figurojnë në Kuvend Komunal, si shpia jote edhe banesa jeme që figurojnë si pronë private, edhe ato janë pronë private. A janë në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme të qitme, atë nuk e di, në Komunë ato të figurojnë. Kam qef këtu me ma shpjegue mu, në qoftë se janë ato në prona private, çfarë zgjidhje do të bësh me ta. Edhe e dyta është te 1184, te veterinarja aty, edhe aty e ke të njëjtin problem, aty i ke tri banesa që janë në pronësi të personave. Është mirë me bo banesë kolektive sociale, edhe kam me votue për, por në qoftë se ka mundësi me na shpjegue neve këtu, para se me votue nesër, në qoftë se bësh banesë kolektive, a do t'i kompenzosh ata qytetarët për ato lokale, a do t'ju japësh banesa, a do t'ju japësh lokale? Në qoftë se do ta bësh, dy-tri vite, katër vite do të bëhet ndërtimi i banesave kolektive, ku do t'i çosh ata qytetarë, a do t'u bësh pagesë mujore apo do t'u japësh banesa, a çfarë zgjidhje do të bësh? Se unë tash, veç Ad hoc e ngre dorën edhe me votue...është mirë, se ata janë qytetarë tanët, kanë banesa private, edhe çfarë zgjidhje do të bësh me ta? Sa për te trafa atje që po duesh me i vu, është mirë, e di në Dragash është, te ura, është në anën e majtë kur të shkosh për në Brod, është 21 metër katrorë, është mirë. Në Brezne, këtë parcelën që po e bëjmë për ujërat e zeza, a është prnë private kjo, edhe a keni ndonjë marrëveshje me ta – se nuk e di sa e ke përcjellë, kemi pas na një problem me shkollën e Buqes. E kemi bo marrëveshjen, masi e kemi bo marrëveshjen, masi e kemi qit këtu me e shpronësue, është bo pishman qytetari atje edhe na është kthye prapë. Edhe sot e asaj dite, shkolla e Buqes nuk figuron si shkollë e re.

Bexhet Xheladini: Me sa e di unë, ne veç e kemi shpallë tenderin për Imiantin e ujërave të zeza në Brezne, në këtë pronë ku duam ta shpallim interes të përgjithshëm, sepse personi ka pranue që t'ia japë Komunës për kompenzim – diku afër 19 apo 20 ari, aty për afërsisht është. Është një person shumë i ndërgjegjshëm, i cili do t'i ndihmojë edhe fshatit, edhe Komunës. Kështu që, varësisht qysh ta bëjë vlerësimin Ministria e Financave, ne si Komunë do t'ia paguajmë. Në këtë drejtim, te Impianti për ujërat e zeza në fshatin Brezne nuk kemi problem, për arsye se i kemi të siguruara edhe mjetet – diku afër 300 mijë euro, edhe projektin e kemi bo. Me sa e di unë, dje mos ka dalë tenderi, nuk e di saktë, nëse nuk ka dalë, del sot. Kurse, sa u përket këtyre tjerave, ku dona me shpallë interes të përgjithshëm, te Sharr Prodhimi te ndërtesa, dhe te kjo e veterinarisë, ne po e bëjmë privatizimin e tokës. Ne kemi edhe zgjidhje tjetër, për ata banues aty që e kanë pronën. Prona është e shenjtë, ne nuk ua marrim

pronën. Pastaj, Komuna bën marrëveshje me pronarët, edhe ua jep diku tjetër. Ata që kanë lokale, do t'u japim lokale, ata që kanë banesa, do t'u japim banesa. Kështu që, besoj që ky është një problem që zgjidhet. Qëllimi ynë është që, ato tokat të cilat i duhen Komunës dhe interesit publik, mirë është që me i marrë në pronësi Komuna, e jo ndonjë pronar privat. Ky ka qenë qëllimi, e unë besoj që ky është edhe qëllimi juaj, edhe ju sigurisht që këto do t'i përkrahni, sepse është në interes të përgjithshëm, nuk është në interes as të një personi, as interes privat. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, shumë mirë në Brezne që po bëhet, edhe e njoh këtë person, është përnime burrë i mirë. Ti mu a më kallxojsh, në qoftë se bëhet shpronësimi ku do t'i marrësh paret për me ia dhënë atij, se e dish shumë mirë, brenda dy viteve në Komunë të Dragashit, operatorëve ekonomikë ju ke borxh mbi 2 milionë euro. Kam shumë informata, se erdha prej posht unë. Nashta keni mund me më pa në kamera, një gjysmë ore jam sjellë nëpër Komunë, me marrë informata për me ardhë pak i përgatitur këtu. Sa për te lokali te veterinaria, 1184 – është mirë, se është e arsyeshme kërkesa juaj se do të bëhen banesa sociale. Sa për te 773-shi, edhe 771/8, ti e ke interes publik një park me e bo. Ti kur ta bojsh qat parkun – parkun e kie – qysh do t'i kompenzosh ato lokalet? Te tjetra po të arsyetoj edhe kam me e votue. Janë banesa, i largon, i kompenzon, ju jep banesa me qira, kur të ndreqet aty mundesh me ju dhënë, ti e dish atë – problemi yt, në qoftë se je kryetar – në qoftë se nuk je kryetar, ka kush punon. Problemi tjetër është me këta – ti e ke bo interes publik, pika e dytë e ke bo park të qytetit. Ti do t'i prishësh lokalet e tyre edhe do ta bësh park. Lokale ku do të marrësh me ju dhënë? Se aty janë katër-pesë lokale. Aty janë lokale. Ta kishe bo një ndërtesë, sikur këtë tjetrën, do t'ua jepshe një lokal ose një banesë. Po ti aty po e bëjsh park, parkun, 14 vjet PDK-ja s'e kemi mbikëqyrë, qe katër vite po e bëni ju, qetash po e bëni interes publik, park. E jepshit një arsyetim, po e bëjmë një ndërtesë. Edhe arsyeshmërinë shumë të ulët e keni. Do ta bëni një park – parku ekzistues është – do t'i prishni lokalet edhe do t'ju jepni lokale tjera. Komuna e Dragashit, qyteza e Dragashit nuk ka katër, pesë, gjashtë, a dhjetë lokale me ju dhënë tjetërkund. Po unë e di që s'merret, o kryetar, se ta kthen Ministria. E di që s'merret kjo, kthehet prapë, ju e keni qit veç me qit hi. E qeshtu thuaj, se na s'po e marrim, se unë e di që Ministria ka me e kthye prapë, e qato kam me ta votue.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Para se me i qit në votim, a po i qesim bashkërisht krejta, a po i qesim një nga një? A jeni për me i qit krejta bashkë, edhe nesër krejta një nga një kanë me u votue. Okej, atëherë po i qesim krejta bashkë. Kush është për këto pikat – deri te pika e shtatë që janë për shpallje të interesit? A ka kundër? A ka abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe 2 abstenime, miratohen të gjitha pikat. Atëherë, fillojmë te pika e tetë: Shqyrtimi i Kërkesës së përfaqësuesve të Sindikatës së Administratës së Komunës së Dragashit për ndarjen e mjeteve financiare për kompenzimin e shpenzimeve për shujtat e punëtorëve/zyrtarëve publikë të Administratës së Komunës së Dragashit. A do dikush me e marrë fjalën këtu?

Artan Loshaj: Ne e kemi parë një kërkesë të sindikatës. Mu po më doket që është mirë, kam me e votue. Ama po më doket shumë e qëllimshme, edhe kur e dimë që ribalancë të buxhetit nuk ka. Ne buxhetin e kemi votue, në 2024 për 2025. Këtu janë 4 euro dita. Afër 22 ditë në qoftë se i ka muaji, 88 euro, herë tri vjet, unë e kam bo një plan, mbi 300 mijë euro janë. Unë jam për me i dhënë, por duhet me e pyet kryetarin, a ka pare kryetari. Se kryetari ka 2.5 milionë euro borxhe operatorëve ekonomikë. S'po di, unë jam për me i dhënë, po ku i marrim na ato paret. Megjithëse, edhe me e marrë ne atë vendim, s'ka, se veç për ujësjellësin 500 mijë euro përmbaruesi i ka marrë. Për dy vjet, 2.5 milionë kemi borxhe. Na këtë vendim me e marrë veç për çështje politike – sivjet që i kemi zgjedhjet, me thënë po, ne do t'u japim, se edhe unë kam me u thënë, se edhe unë lypi vota. Ama, paret s'un i marrin ata. Në qoftë se ka mundësi, kryetar, me na kallxue neve, ku ke lluft me marrë na 300 mijë euro, se e kemi edhe një kërkesë të shëndetësisë. Zonja Kryesuese, një kërkesë të shëndetësisë a e ke qaty? Ai është problemi jonë, kryetar, sikur ju në zyrë të LDK-së që po i merrni. Na bëjmë këtu politikë. Unë po të them ty, unë jam për me ua dhënë ato paret... unë kur folish, kryetar, a e dish sa të ngoj, pasha Zotin. Parëz nënkryetari tha e kemi ftohtë, ty po të vjen nxehtë, s'po tash cilin me e ngue, a e keni ftohtë, a e keni nxehtë sivjet. A ka mundësi me m'kallxue, qet kërkesën – unë jam për me jau dhënë, edhe GP i PDK-së jemi për me jau dhënë këto paret - veç a ka mundësi me m'kallxue ku mundim me t'i marrë na këto pare, kam qed kah Bresana, kah Kuki qanej me t'i marrë. Mbi 300 mijë euro, edhe nja 70-80 mijë euro kërkesa ne i kemi të sindikatës, qe 22 muaj na keni ndërprerë këto, është lënda në gjyq. Edhe për këto lypi një përgjigje. Një herë kam qef me dalë qetu, se unë jam për me jau dhënë. A, në qoftë se dona pa politikë me dhënë – kryesuese, me ty tash e kam, se je shefi jem – në qoftë se mendojmë, se unë jau jap edhe një propozim të mirë, me dalë pak prej krizave ju pozita, ne mendojmë për shembull me e lënë në shtator, me jau votue për 2026-tën me i marrë ato në mënyrë retroaktive, ato s'bëhen, se shumë borxhe keni. Ti s'e dish se jetosh në Prizren, Komuna ka shumë borxhe. Krejt investimet sivjet që kanë me i bo, kanë me i bo ato, po operatori ekonomik pare s'ka me marrë. Krejt në përmbarus kanë me shkue, edhe paga s'kemi me pas. Më mbani për fjalë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë Artan, kjo kërkesa ka ardhë para dy muajve. E kemi shqyrtue këtë kërkesën bashkë. Jo, kjo është bërë prej sindikatës, jo absolut. Unë hala, prej se jam bërë kryesuese, s'e kam shkelë zyrën e LDK-së. Para dy muajve më ka ardhë, edhe unë i kam thënë kryetarit të sindikatës që pa e shqyrtue mirë, pa e kqyrë edhe paret a janë, pse me ardhë një kërkesë edhe mos me pas nesër. Ka qenë vullnet i kryetarit, ai e ka prit këtë për me e fut në rend të ditës, por këto pare kanë me u dhënë prej vitit të ardhshëm, pjesë-pjesë, me buxhet të vitit 2026. Një kërkesë e shëndetësisë më ka ardhë, por ajo kërkesa ndoshta do të vonohet, si kjo kërkesa tjetër. Duhet me u shqyrtue për mos me na u kthye prapë, që me qenë e ligjshme. Tash nuk do ta qesim, por do ta shqyrtojmë sikur qysh e kemi shqyrtue këtë të punëtorëve të administratës.

Artan Loshaj: Punëtorët e sindikatës edhe punëtorët e shëndetësisë janë punëtorë komunalë, janë të barabartë. Mos po bëni edhe ju njëfarë politike, me kqyrë, se këta të shëndetësisë ma shumë janë të PDK-së. Unë po kërkoj që nesër në pikën e rendit të ditës, si pikë e nëntë e rendit të ditës të jetë edhe kërkesa e sindikatës së shëndetësisë. Është e njëjtë, punëtorë janë ata, punëtorë janë këta. Punëtorë të Komunës janë administrata, ne nuk jemi të Shishtavecit, shëndetësia. Jemi 5-6 punëtorë shëndetësorë, me ia shti në rend të ditës sindikatës së Komunës, e mos me hi të shëndetësisë, kjo është e pakapshme. Edhe ti duhet me na përkrahë, kryesuese, se të kemi kolege. Kur mbi 300 mijë euro janë të Komunës, s'po i shtini edhe 70-80 mijë të shëndetësisë. Mshili sytë një trohë, kallxo forcën, na ndihmo një trohë kolegëve. Unë kërkoj që nesër – të hyjë në procesverbal kjo – edhe nesër si anëtar i Komitetit me kërkuje që kjo kërkesë të jetë pikë e rendit të ditës. S'ka gajle, kryetar, e shkurtojmë pak ma shumë, i bëjmë shtatë pika me një vend, ose i shtijmë të dyjat, se një kërkesë është. Del këtu, kolege, shumë kam qef ty me të pa t'u folë. A u morëm vesh, në procesverbal me e shkruar që Artan Loshaj kërkon që kjo pikë të jetë nesër pikë e rendit të ditës, se është e njëjta kërkesë, i njëjti problem është, bile na tri herë ma pak kemi kërkesë pare, se këta. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Ti je i zgjedhur i popullit, duhet me e kqyr ligjin edhe drejt me punue. Kërkesa e Administratës ka ardhë qe dy-tre muaj. Kërkesa juaj ka ardhë masi është caktuar mbledhja e Asamblesë. Po normal, edhe e di saktë edhe sigurt, kush e ka nis, kush e ka bo. Unë nuk jam kundër, absolutisht. Asambleja le ta shqyrtojë, le ta marrë vendimin. Unë po mendoj për kërkesën e sindikatës së punëtorëve të Komunës. Në seancën tjetër, kur të na kthehet vendimi prej MAPL-së për këtë vendim që po e marrim, e shohim qysh po na kthehet vendimi, pastaj e futim në rend të ditës edhe kërkesën e shëndetësisë. E dyta, punëtorët e Komunës janë më të diskriminuarit në Kosovë, sa i përket shërbimit civil. Kurrë nuk kanë marrë as shujta, as nuk kanë marrë shpenzime të transportit. Derisa ka hy në fuqi Ligji për Pagat, ju keni marrë. Këta nuk kanë marrë kurrë. Pagat i kanë shumë më të ulëta se të juajat. Edhe pse e kanë bo këta një kërkesë para dy-tre muajve, e ju menjëherë, për inati me e bo. Propozimi im është, le të shkojë një herë e Komunës, pastaj në seancën tjetër, le ta fut kryesuesja në rend të ditës edhe kërkesën e juaj, nuk është problem. Tash, a është apo nuk është e ligjshme kjo, a do të ketë apo s'do të ketë pare, ajo është çështje që do të shihet ma vonë. Unë nuk po bëj politikë, se unë nuk e kam bërë këtë kërkesë, e ka bo sindikata, e ka bo edhe sindikata e juaj, që është dashtë me prit pak, jo aq shumë me u ngut, por megjithatë është e drejtë e sindikatës me e bo. Mendimi im është që një herë le të shqyrtohet kërkesa e sindikatës së Komunës, pastaj, në seancën tjetër, edhe kërkesa e sindikatës së shëndetësisë. Edhe, ja ti ke marrë pare, ja kërkush qetu, ke marrë pare ndoshta edhe që s'të takojnë, po pak duhet me qenë pak më racional. Edhe ato paret që po duesh me i marrë janë të popullit, le të t'dhimën edhe paret e popullit pak.

Artan Loshaj: Kryetar, unë pata qef me bo politikë normale, po ti e qite pak si në personale. T'kujat

pare i marrish ti? T'kujat? Të popullit, shumë thjesht. A punojmë na atje? Mos po lypim lëmoshë? Ato pare i kemi marrë, janë ndërprerë, edhe ato pare s'jam t'u i lyp për Artan Loshajn, jam t'u i lyp për 100 punëtorë. Kërkesa që është bërë – znj.kryesuese, unë kërkoj nga ti që të jetë pikë e rendit të ditës, se nuk i është bërë veç kryetarit të Komunës, i është bërë edhe kryesuese së Kuvendit Komunal. Edhe ti je e obligueshme një kërkesë me e pru, a kalon a s'kalon është tjetër send. Problemi është që ti duhet me e qit si pikë të rendit të ditës, me e shqyrtue na. S'kalon e jona, nuk kalon. Unë e di që nuk keni pare, nuk keni pare me i bo edhe qato projektet e sivjetshme, e jo më me dhënë pare gjysmë milion euro. 2.5 milionë – kryesuese – borxh i ka Komuna, operatorëve ekonomikë. Kjo është puro politike, se i kemi zgjedhjet sivjet. Nuk ka pare me marrë administrata prej Komunës, edhe punëtorët shëndetësorë. Nuk ka pare, jo që nuk ka vullnet kryetari, këtë e di shumë mirë. Nuk ka pare. Sivjet keni me i pa operatorët ekonomikë, nëpër përmbaruesia kanë me shkue. Kjo është veç politikë, se keni dalë të tretit, e po tutnu mos po delni edhe mas JGP-së, të katërtit. Kjo është politike, nuk ka pare. E vetmja mundësi është me hi në buxhet, me i marrë në 2030-tën këto paret. Me hi në proces – është mirë – në pritje. Po, unë jam për sindikatën e administratës, do të votoj për, edhe për sindikatën e shëndetësisë, po këto pare me PDK-në nashta i marrin, me ju deri në 2030-tën jo. Nuk keni, keni lënë borxhe. Unë erdha prej Zyrqës së Prokurimit, unë erdha prej Urbanizmit, gjysmë milion euro veç operatorit ekonomik për Ujësjellësin ia ka marrë përmbaruesi. E di mirë kryetari këtë, po këta bëjnë kuse s'po dinë këtu. Po do sende i dimë na, edhe na jemi qytetarë të këtij vendi, edhe na jemi asambleista, edhe na kemi lyp vota, edhe na jemi për qytetarin. Unë kam qef, edhe kërkoj nga ti, se e bësh këtë politike edhe biesh shumë keq, kryesuese – kërkesa e administratës jam për edhe do ta votoj nesër, me hy në buxhet. Por unë, paralel me këtë, dola edhe për të shëndetësisë, se është kërkesë e jotja. Qite veç e veç me e votue, mos e votoni, i keni votat. Unë kërkoj – se edhe Kuvendit Komunal, e kryesuese i është bërë kërkesa, nuk i është bërë veç kryetarit të Komunës.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Kjo kërkesë mua më ka ardhë pasi i kam bo pikat e rendit të ditës, më është drejtuar edhe mu, edhe kryetarit të Komunës. Unë këtë kërkesë nesër nuk do ta qes në pikë të rendit të ditës. Arsyeja është sepse mu më ka ardhë pas rendit të ditës. Ne kemi seanca tjera, kështu që do ta shqyrtojmë. Jo që do ta shqyrtojmë, por jam pro kësaj kërkesës dhe çdo kërkesë që vjen prej punëtorëve që punojnë nëpër institucione shtetërore, una jam ajo që do t'i mbështes. Sa për politikë, ne prej politikës kemi ardhë, do të bëjmë politikë, e kemi vitin e fushatës, ja këtu kemi me bo politikë, ja kërkund. Por, edhe unë kisha kërkue, Artan, një bashkëpunim shumë të mirë mes meje dhe teje, këtu te kjo kërkesa, për arsye se ne këtë kërkesën e sindikatës së administratës e kemi. Kështu që, unë kisha kërkue këtu publikisht, unë edhe ti duhet me bashkëpunue, që kjo kërkesë të futet në rend të ditës në muajin tjetër, që të jetë më e drejtë dhe ta presim kjo kërkesa qysh po kthehet prej MAPL-së. Në qoftë se del kjo pozitive, atëherë na e qesim. Në qoftë se ata kërkojnë diçka te kjo kërkesa tjetër, atëherë e

përgatitim që kjo kërkesa të mos na kthehet prapë. Kështu që, unë nuk kisha dashtë që ne të ngutemi edhe ta marrim një vendim, se s'do me thënë gjë, se ne do t'i mbështesim ata patjetër, kur ta qesim pikë të rendit të ditës – unë i kam edhe kolegë ata, unë do ta mbështes. Por, ne të dy duhet me pas një bashkëpunim shumë të mirë që kjo kërkesa, pasi që ka ardhë pas rendit të ditës, ata e dinë që nesër ajo nuk do të qitet, unë do t'i takoj këta të sindikatës – siç i kam takue këta të sindikatës së administratës – do t'i thirri edhe këta dhe do të bisedoj, që kjo pikë ka me qenë në rendin e ditës në seancën tjetër. Veç kërkoj një bashkëpunim, të mos ngutemi, të mos dalim përpara, që kjo të jetë sa më funksionale. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryesuese, masi është në votim edhe duhet me e votue këtë pikën e rendit të ditës, mu kam qef me ma përpilue kryetari – jam për me ua dhënë – qysh do t'ia japim? A do të hyjë, me e lënë në buxhetin e shtatorit, me e votue për në mot me i dhënë, apo do të votojmë sivjet me i dhënë këto paret. Edhe, problemi është ku, në cilin kod buxhetor do t'i marrim këto pare. A, sa për që s'un e shtish në rend të ditës, shumë mirë e dish, kur vijshna në seancë veç na keni pru fletat – edhe qet pikë po e shtimë, edhe qet pikë po e shtimë. Edhe këtë shtije, mos të kalojë. Është shumë në rregull, po e keni bo ju këtë. O kryetar, është e ulët kjo e jotja, o kryetar. Se unë pak pare kam prej tesh, po kam ma shumë fytyrë. Mos, mos më shti në personale, se kurrë s'kam pas qef. Due me të respektue si kryetar, duet me të respektue si i moshuar, due me të respektue si mjek edhe si shok i rahmetlisë tem. Mos hi në personale, se nuk ta qet, kryetar. Mos hi në personale, se 44 euro qetash t'i jap. Nuk jam i unët shumë për pare, mos, se është fjalë e rëndë kjo. Pse po insistoj unë, se janë 100 punëtorë, unë jam në fushatë zgjedhore. Unë due me të çue në shpi ty, po due me të çue në shpi sivjet. Qetu është problemi, në shpi po due me të çue. Në zgjedhje, po due me të çue në shpi sivjet ty, në mot me shkue në penzi, me familjen tënde, si plakë, m'u knaq me familje, me fëmijë, me mbesa, me nipa, me ndonjë pacient qaty me u knaq. Po du e me të çue në shpi, se je penzionue. Se të kam thënë në fillim, ke me shkue për një mandat. Në rregull, s'po të them kurgjo unë, unë kam qef me të çue në shpi. Unë me pushkë nuk të çoj në shpi, koha e pushkës ka kalue, kam qef me laps me të çue në shpi, me vota. Duhet me u dënue fjalët e ekzekutivit ndaj delegatëve. I unët? Nuk jam i unët unë. Unë kam pas fytyrë, o kryetar, e sot që kam pare, mos, se është e ulët. Ngrihi fjalët pak, se shpesh po më thuesh, mos, mos e qit personale.

Bexhet Xheladini: Dëgjo, mos hajde këtu me shit politikë, me bo propagandë. Ti po gënjen këtu që Komuna ka 2.5 milionë euro borxh. Nuk i kemi borxh kërkujt hiç. Tash e tutje nuk e di, deri sot kërkujt hiç. Asnjë cent, asnjë euro. Mos bën propagandë këtu, mos shpif!

Arijeta Skeraj: Artan, të thashë edhe pak më herët, duhet me qenë pak bashkëpunues. Atë kërkesën thashë unë nesër nuk do ta qes në Kuvend. Mu kur të më vijnë kërkesat masi ta bëj rendin e ditës, unë due me e shqyrtue. Unë kam jurista, unë nuk e di a duhet me u qit a nuk duhet. Ato pikat nuk është veç partia ime që i ka pru. Unë qe 18 vjet në Asamble, bile-bile neve na kanë thirrë edhe përpara derës, na

kanë thënë kemi me e qit një pikë të rendit të ditës, ke me e mbështet. Nuk jam e sotshmja unë. Bile PDK-ja ma shumë ka pru pika, kurrë bile ne si asambleistë të LDK-së nuk kemi dalë sa dilni ju përjashta. Por, po duhet me shujt edhe po duhet me vazhdue për një punë më të mirë për qytetarët e Kosovës. Ne politikë jemi duke bo edhe politika na ka pru. Shumë ofendime unë kam marrë edhe këtu, po secili për fytyrën e vet e ka. Po kryetari i Komunës është kryetar i Komunës. Nuk mundesh ti me i thënë kryetarit po due me të çue në shpi. Ka njerëz që dojnë me e çue në shpi ndoshta, po veç një votë e ke, Artan, ka plot vota këtu që ndoshta ka me ndejt kryetari këtu. Nuk është mirë, se shumë herë po kapnu në personale me kryetarin. Kryetari e ka një moshë, edhe ja ky kryetar ka tolerue, ja askush. Salim Jonuzi nuk ka tolerue kështu. Salim Jonuzi të ka thënë dil jashtë edhe s'ia ka ndie. I vetmi kryetar është që po toleron edhe po bën lëshime. Të lutem, Artan, se çdo seancë është tendencioze. Hi kqyri seancat na kur jemi konë në opozitë, deri në fund ka shkue qysh ka shkue. Asnjë seancë nuk është duke shkue me kuorum. Qeshtu e kallxoni intelektualitetin e juaj. Edhe unë jam konë në opozitë, po kurrë s'e kam lëshue mbledhjen. Hi kqyre mbledhjen a e kam lëshue unë ndonjëherë. Kjo është që ju nuk keni përgjegjësi, se jo për diçka. Po më vjen keq! Atëherë, nuk do ta diskutojmë, e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe 2 abstenime, e miratojmë këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e nëntë: Miratimi i Raportit dhe Planit të Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit për vitin 2024. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Kjo është pikë shumë e gjatë edhe nesër unë do të diskutoj, po është problemi që – një kërkesë kryetarit – nesër le të jenë drejtorët këtu, se puna e secilit drejtor është nesër, edhe plani i punës për 2026-tën është këtu. E jo sa herë ka dashtë drejtori me folë, me marrë fjalë vend e pa vend. Nesër është koha e tyre, është dita e tyre, edhe kam qef që kryetari bashkë me stafin e vet, nesër me qenë të gjithë prezent për raportin e punës 2024 dhe për planin e punës 2025. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër?

Munir Jonuzi: Sot do të shfrytëzoj të drejtën time për të bërë disa pyetje. Në listën e investimeve kapitale në faqen 9, asfaltimi i rrugëve në rajonin e Gorës është i bashkëfinancuar me MAPL-në. Këto projekte nga Granti ndoshta janë projekte të performancës, a janë përfunduar të gjitha rrugët e planifikuara? Faqe 13, në fushën e kulturës, projekti i ruajtjes së folklorit, jam kurioz kur ka ndodhur kjo ngjarje? Kemi vendime për ndarjen e mjeteve për TV Prizreni, dhe meqë nuk e kam parë në kuvend, jam kurioz pse i kanë marrë këto mjete. Faqe 16, pagesa e shpronësimit për AKP-në, më intereson se cili projekt dhe sa është paguar. Deri ku ka arritur kërkesa e LMT-së për furnizim e autobusit për transportin e nxënësve nga komunitetet joshumicë? Njoftim për të gjithë perfaqesues e fshatit se do të fillojë të paguhet mirëmbajtja e ndriçimit, ne kemi numrat e tyre, duhet t'i informojmë personalisht dhe jo vetëm përmes faqes në Facebook. Faqe 18. Aplikim për punësim, 33 aplikime, a kemi 33 vende të

lira të shpallura në vitin e kaluar. Në faqen 20 keni postuar lidhje me procesverbalin, gjë që rrit transparencën, e vetmja gjë që është e gabuar është mosrespektimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në këtë proces sepse nuk gjeta përkthime në gjuhën boshnjake/serbe. Kërkoj nga ju që të siguronit dygjuhësi të plotë në të gjitha dokumentet zyrtare dhe akses të barabartë në informacion për të gjithë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë, kryetar, ishte kërkesa që nesër të jenë të gjithë drejtorët, pasi që është raporti dhe plani i punës. Është mirë që ata të gjithë të folin për raportin dhe planin që do ta kenë. Kështu që, edhe në emrin tim i bashkëngjitem kësaj të Artanit, që të gjithë drejtorët nesër me qenë këtu. Atëherë, e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me Me 4 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e tretë të KPF-së, pikën eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Unë i kam dy pyetje për kryetarin. E para është në fshatin Rrenc, rruga Kapre-Rrenc. Ma herët na ka premtue që në hyrje të fshatit do ta rregullojë rrugën, nuk është bërë. Na ka premtue te varrezat, në pranverë do ta bëjë murin mbrojtës, nuk e ka bo, tash ka lind edhe një problem. Qytetarët kanë qenë në Zyrën e Prokurimit, është problemi me varrezat kur i kalon te fshati Rrenc, për Kapre, në anën e majtë, nja 100-200 metre, është një ujë edhe një bazen aty. Aty ai uji figuron prej vitit 1973, mbi 12 familje marrin ujë me ramje të lirë. Ata janë të shqetësuar se aty do të mbulohet ajo pjesë. Unë kam qef që atë pjesë mos ta prek kryetari me stafin e vet. Ka vend aty, le të kalojë pak në anën e majtë. Edhe në qoftë se e prish atë bazen, nuk është mirë me e prish, është mirë me e meremetue mirë, se aty do të kalojnë automjete, do të kalojnë mjete të rënda. Edhe, në qoftë se e largon prej asaj pjese, në pjesën pak më të poshtme, në qoftë se ka vend, le ta bën riparimin e atj uji. Aty mbi 50 vite figuron bazeni dhe figuron uji. Është mirë me bo zgjidhje, jo tash pse është i nervozuar me mu, edhe për inat timin me shkue me thënë unë nuk do ta ndreqi. Edhe e dyta është, kryetar, na ke premtue në seancën e fundit për Tv Opojën, se nuk je i njoftuar pse pjesa e dytë, më 18 dhjetor, pjesa e dytë e seancës mungon në Tv Opoja edhe pse ka qenë live. Ti e ke lujt rolin e viktimës, qysh e kie marak, ke thënë nuk e di pse, nuk e kam pa, do të bisedoj me Tv Opojën edhe në seancën tjetër do t'ju informoj se çka ka ndodhë. Unë po kam qef me të pyet sot në Komitet, se nashta nesër shuma ka delegatë edhe shumë ka pika të rendit të ditës. Mos me të ngarkue, unë po kam qef sot me e ditë, a ke bisedue me ata, çfarë informatë ke marrë, çfarë përgjigje të kanë dhënë, pse ka ndodhë kjo edhe kush iu ka bo presion atyre? Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Sa i përket Rrugës Kapre-Rrenc, para dy jave, kompania e cila ka qenë e kontraktuar me i krye këto punë, i ka fillue punimet për me e përfundue asfaltimin e rrugës. Mirëpo, prishja e kohës ka bo që ta ndërpresin ata punën. Po megjithatë, ka lind një problem te ajo pjesa ku e përmendi Artani. Është njëfarë rezervuari aty. Ata masi e kanë rregullue, masi është pajtue, dikush ka shkue ka ngacmue aty, edhe tash kanë dalë disa familje edhe kanë pengue që rruga të vazhdojë të punohet aty. Por ne,

megjithatë, jemi marrë vesh që atë problem ta zgjidhim. Po Artani e ka dëgjue këtë problem, e ka dëgjue që do ta zgjidhim, e del ky këtu bën politikë, kurse ky e ka nis këtë, e ky po e bën, e ky po e kryen. Kështu që, këtë do të bëjë Komuna, do ta bëjmë na. Po ky çdo herë, si Nexhmidin Sejdlari edhe ky, kur e dëgjon që na ndonjë punë kemi me e krye, ky del këtu edhe bën politikë. Për Tv Opojën, po, kam bisedue atë ditë, pra ka qenë një problem me internetin. Këtë problem thanë që e kemi zgjidhë dhe do ta qesim pjesën e dytë. Kështu që, ka mundësi edhe e kanë qit, nuk e di. Sigurisht, unë sot i marr në telefon dhe ata e qesin, nuk është problem. Por, megjithatë, e ke edhe në Radio SHARR, mundesh me e pa. Por edhe ata kanë me e qit, se masi i kemi pague, ata e qesin. Unë të tregova çka kanë thënë ata. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, në qoftë se e ke marrë ofendim që të kam thënë shko me nipa e mbesa me rrit, të kërkoj falje! Unë jam burrë. Po si plak, se 70 vjet i ke. Që ndihesh i ri, se robi plaket kur do vetë. Po kam qef me të çue në shpi. Zoti t'i ruaj, se unë jam burrë, të kërkoj falje në qoftë se je ofendue. Unë nuk jam si ti, dalloj prej teje. Po edhe unë jam populli, jo Artani, edhe unë jam populli. Edhe unë kam qef – unë nuk të thashë kam me të çue me zor në shpi – unë pata qef edhe shumë kam qef me të çue në shpi, prapë po të them, unë nuk e fshehi atë. Po unë s'po të çoj sot, se me pas mundësi qetash të çoj. Po të çon populli, në zgjedhje, bashkë me popullin kemi qef me të çue në shpi. Si të je ndie i ofenduar që të kam thënë si plak 70-vjeçar, me shkue me nipa e mbesa, unë të kërkoj falje. A sa ti që më krahasosh mu, unë jam Artan Loshaj dhe asambleist jam për ty, kryetar. Sa që më ofendosh mu edhe më krahasosh me asambleista tjerë – s'po due me e përmend Nexhmidinin – mos. Atij i ke thënë edhe kriminel e s'di çka i ke thënë. Mos më shti me ni thes me tjerit, po të lutem. A sa që dësh me m'qit prej taktit, ani se foli unë kështu, zamet e kam me dal prej taktit. Veç, kur dal prej taktit zamet e keni me m'ndalë mu. Mos të himë, kryetar, për personale. Po nuk është personale me të thënë po due me të çue në shpi. More, unë nuk po hi me ty, unë si kryetar, me Bexhet Xheladinin, me doktorin, me prindin, me shokin e rahmetlisë, unë kam respekt. Si kryetar i Komunës, kam qef sonte me të çue në shpi. U krye muhabeti, si të vijnë zgjedhjet, kam me lobue me shkue ti në shpi. S'po të them kurgjo, edhe me u knaq me nipa e mbesa. Sa për Tv Opojën, unë kam qef me e pa, mos me impono me e kqyrë Radio SHARRI-n. Nuk e due, more burrë. Ti qaq po dësh me bo imponime, si në Kore të Veriut, qetu edhe pikë. S'po due unë, unë po due me e pa Tv Opojën. Edhe s'mund me pas probleme në live. Me pas qenë sikur këtë tjerët që po incizojnë, mund mos me pas valë. Ai ka qenë direkt incizim, ka qenë live ajo. Na e kemi pa, unë kam dalë përjashta e kam pa bisedat ju që i keni bo këtu. Edhe menjëherë e keni pre atë. Është mirë, edhe bëni shumë mirë, me e kthye pjesën e dytë të seancës së dhjetorit. Po të them edhe një herë, sot e ke teprue, e vazhdove me m'krahasue me Nexhmidin Sejdlarin. Secili i kemi karakteristikat e veta dhe personalitetin tonë. Të lutem, mos më krahaso me asambleista tjerë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë i kemi edhe katër

kërkesa. Po vazhdoj t'i lexoj. Një kërkesë është prej familjes strehuese Agim dhe Selvinzae Skeraj. E dini që kjo familje i rrit fëmijët, dhe kjo familje çdo herë është mbështet nga ne. Atëherë është mirë, në qoftë se edhe ju mendoni që ta mbështesim. QPS-ja e ka bo këtë kërkesën në emër të tyre, edhe shumën e kanë lyp 1500 euro. A jeni pro kësaj kërkesë, që t'i mbështesim?

Bexhet Xheladini: Ne që dy vite e mbështesim këtë familje. Ka qenë mbështetja 1200 euro, tash janë rrit shpenzimet, edhe unë mendoj që kjo është një kërkesë e arsyeshme, 1500 euro me ia nda si Komitet. Po është çështje e juaja, mundeni me vendos.

Arijeta Skeraj: Atëherë, kush është pro kësaj kërkesës? A ka kundër? A ka abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë kërkesë. Atëherë një kërkesë tjetër më ka ardhë nga Miradete Elmazi nga fshati Shajne. Besoj që e keni parë në rrjete sociale, është për atë fëmijën që e kanë çue për shërim jashtë vendit. Edhe kjo është një kërkesë që duhet ta mbështesim. Kjo nuk e ka cek shumën. Atëherë, është mirë edhe këtë me e mbështet me shumën maksimale. A jeni dakord për këtë kërkesë? 1500 krejta do të jenë. Po, por kjo ka marrë edhe prej Ministrisë, edhe prej krejtve. Nuk është problem, e bëjmë edhe 1900 e sa, masi kjo kërkesa po shkon kështu, mos t'i ndajmë, se krejta nga 1990 a do të kemi mjete, bile pak.

Artan Loshaj: Tash, po tutem edhe me folë, se po e marrin politike. Unë e di këtë familje, kjo më doket edhe prindin nuk e ka. Është mirë këtij të Rrencit që i dhamë, po unë si Artan – masi jam punëtor shëndetësor, edhe kryetari, e ti je këtu – nuk mundesh me e krahasue një që e ushqen një fëmijë të shëndoshë – nuk jam kundër, edhe 5000 po ia japim Agimit – po kjo është një sëmundje e vazhdueshme e saj edhe ka hek shumë. Edhe në anën financiare është shumë e dobët, është rast social. Unë si Artan – pa politikë, se bare në shëndetësi, për sëmundje mos të bëjmë politikë – unë kërkoj që shuma maksimale t'i ndahet kësaj familje.

Arijeta Skeraj: Okej, Artan. Atëherë, e bëjmë maksimalisht, 2000 euro. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, edhe kjo kërkesa miratohet. Në KPF herën e kaluar ka bo kërkesë edhe i ndjeri Naser Myrtezani, dhe ndoshta unë që nuk kam mund me i qit këto kërkesa, masi e kam mbyllë m'u ka kujtue, atëherë e kam sjellë edhe një herë për z.Naser, që t'i jepet një shumë, masi edhe ka qenë ish-asambleist i Kuvendit. Kisha kërkuar që këtë kërkesë, edhe pse është i ndjerë, po t'u shkojnë dy fëmijëve që i ka. Edhe për këtë kërkesë do të shkojmë me shumë maksimale. Kush është pro kësaj? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë kërkesë. M'u më është drejtuar edhe një kërkesë për një pronë komunale nga Ramadan Seferi. Siç e dini, Komuna nuk ka të drejtë të falë toka publike për personat fizikë. Atëherë, nuk e qesim këtë kërkesë, se e ka lyp ai një pronë komunale, që na s'e kemi edhe atë të drejtë me i dhënë pronë.

Artan Loshaj: Nuk po due tash – se edhe jam në emocione për të ndjerin Naserin – nuk po due me të

bo diss, po pak më herët më thaje që kërkesa e shëndetësisë duhet me u shqyrtue nga ju dhe kryetari, edhe për me dalë. Unë kisha pas qef këtë edhe tjerat, me kryetarin edhe ju, edhe zyrtari ligjor, këto kërkesat kur të vijnë, me i pa a ka të drejtë ligjore a jo. Në qoftë se s'ka të drejtë ligjore, atëherë ia japish një përgjigje pa na qit neve në lajthitje këtu. Shumë në rregull, po tash në qoftë se nuk kemi të drejtë na edhe e marrim e shqyrtojmë këtë, secili qytetar atëherë ka me bo kërkesa. Për atë jeni ju, është kryetari, është zyrtari ligjor, edhe kërkoj që herave tjera, në qoftë se nuk ka të drejtë ligjore për me bo, ti si kryesuese e ke mandatin me i kthye përgjigje që kjo pikë, për këto shkaqe nuk kalon në seancë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Ne e kemi ditë që kjo është e jashtëligjshme, por është dashtë me e njoftue KPF-në, për arsye që edhe ky që e ka bo kërkesën me e ditë që është e jashtëligjshme. Atëherë, te kërkesa e shëndetësisë, unë nesër nuk due me e qit. Dua ta takoj kryetarin e sindikatës së shëndetësisë, z.Elvir, që ma ka bo këtë kërkesë, në bashkëpunim me kryetarin edhe zyrtarin ligjor, do ta kem një takim pas seancës së nesërme, dhe do ta planifikoj që në seancën e radhës të hidhet edhe ajo kërkesë.

Xhemile Misinaj: Përshëndetje për të gjithë! Meqenëse u ndërlidhem për të ndjerin Naser, unë i shpreh familjes ngushëllime. Edhe, dashta veç me ta kujtue – kryesuese – nesër, para seancës me mbajt një minutë heshtje për nder të të ndjerit. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Xhemile! Këtë e kam paraparë, që nesër të mbajmë një minutë heshtje për ish-kolegun tonë. E mbyllim këtë Komitet! Mirë u pafshim nesër!